



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

Përrurohet objekti i ri shkollor në Gadime



260 mijë euro për rregullimin e infrastrukturës dhe ndriçimit publik për fshatrat Rubofc i Madh, Rubofc i Vogël e Kojskë

Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeit së bashku me Ministrin e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi kanë nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi për financimin e projekteve për asfaltimin, rregullimin e rrugëve, hapësirave publike dhe ndriçimit publik për fshatrat Rubofc i Madh, Rubofc i Vogël, Kojskë dhe ndërtimi rrugës rreth hekurudhës.



Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka pritur në takim Beate Elsässer nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zëvendës Shefe e Departamentit të SDC për Bashkëpunim me Evropën Lindore, Carin Salerno, Shefe e Divizionit të SDC, Shefe e Divisionit të SDC për Ballkanin Perendimor; Katharina Stocker, Drejtoreshë Bashkëpunim / Ambasada e Zvices në Kosovë; Laurent Torche.



Mbahen dëgjime publike lidhur me projekt buxhetin për periudhën afatmesme 2022-2024

Nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit Komunal, Daut Azemi janë mbajtur dëgjime publike lidhur me projekt buxhetin për periudhën afatmesme 2022-2024.



Shtabi Emergjent mban takimin e radhës, 14.949 persona të vaksinuar gjatë muajit Gusht

Nënkryetari Komunës së Lipjanit, Fauz Xhemajli ka mbajtur takim me Shtabi Emergjent pas rasteve të fundit me Covid-19. Gjatë këtij takimi janë diskutuar shumë qështje me rëndësi si dhe gjendjen me Covid-19 në Lipjan.



Gjatë ditës së sotme, udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Daut Azemi është mbajtur mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ku janë diskutuar pikat e rendit të ditës që ishin të parapara për këtë mbledhje.

Anëtarët e KPF-së pas diskutimeve që patën, aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës.



Aprovohet Buxheti për vitet 2022-2024

Kuvendi Komunal i Lipjanit sot nën udhëheqjen e Kryesuesit Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 47-të. Mbledhje në të cilën u aprovuan pikat e rendit të ditës të cilat ishin propozuar për shqyrtim gjatë kësaj seance.

Gjatë kësaj seance ku i pranishëm ishte edhe Kryetari Imri Ahmeti, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Latif Ramadani ka elaboruar propozim vendimin për Buxhetin 2022-2024, dhe pas diskutimeve nga antarët e Kuvendit, është aprovuar Buxheti për vitet 2022-2024.

Po ashtu në këtë seancë janë miratuar edhe propozim vendimi për ndajrjen e mjeteve financiare (Caritasit Zviceran) si dhe propozim vendimi për ndarjen e mjeteve fiancare.



Sot në njësinë e Maternitetit pranë QKMF-së në Lipjan, u bë ceremonia e hapjes “Klasa ë Nëna”, projekt ky i financuar nga AMC (Action for mothers and children) në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit.



Kryetari Imri Ahmeti nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e qendrave për edukim të hershëm në Shalë dhe Magurë



Komuna e Lipjanit lanson Regjistrin e Thjeshtezuar Elektronik të Procedurave Administrative



Edhe një hap më shumë në transparencë
Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me DAI Global LLC e cila operon me intensitetin Komuna Transparente Efektive dhe Llogaridhënëse, në zbatimin e projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM).



Sot është bërë përrurimi i ndriçimit publik nga udhëkryqi Janjevës deri tek hyrja e qytetit në Lipjan. Ky projekt është investim nga Komuna e Lipjanit.



Në Banullë e Janjevë bëhet përrurimi i ndriçimit publik
Në fshatrat Banullë e Janjevë është bërë përrurimi i ndriçimit publik, investim ky nga Komuna e Lipjanit.

Shumë banorë të këtyre fshatrave u shprehën mirënjohës ndaj Kryetarit Imri Ahmeti për angazhimin e tij, kujdesin e treguar në çdo projekt.



Sonte është bërë përrurimi i ndriçimit publik në Gadime. Ky ndriçim publik është bërë investim nga Komuna e Lipjanit që përfshinë rrugën nga fshati Llugaxhi deri tek Shpella e Gadimës.



Përrurohet objekti i ri shkollor në Gadime

Kryetari i Komunës Imri Ahmeti, i shoqëruar nga drejtoresha e Arsimit në Lipjan, Elmaze Behluli në ditën e parë të fillimit të vitit të ri shkollor 2021/2022 kanë bërë përrurimin e shkollës së mesme "Ulpiana" Gadime.



Shkollat e Komunës së Lipjanit gati për fillimin e procesit mësimor

Drejtoresha e Arsimit në Komunën e Lipjanit, Elmaze Behluli ka vizituar shkollat e Komunës së Lipjanit me rastin e fillimit të procesit mësimor që pritet të filloj me 27 shtator, njëherit është mbajtur edhe takimi i task forcës komunale në të cilin u diskutua fillimi i vitit shkollor.



Në Lipjan shënohet Dita botërore e zemrës

Komuna e Lipjanit së bashku me AQH që financohet nga Agjencia Zvicëране për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Swiss TPH ka organizuar shënimin e Ditës Botërore të Zemrës në qytetin e Lipjanit.



Kryetari Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti së bashku përfaqësuesit nga Moto-Klubi “Veteranët e ZON të UÇK-së” dhe Shqiponjat e Zeza, bënë homazhe dhe kanë vendosur buqeta lulesh pranë shtatores së Komandantit Legjendar “Adem Jashari” për nder të ditës Historike e Epopesë së Jezercit.



Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka nënshkruar propozimin e Programit të Praktikantëve në kuadër të projektit “Edukimi për të gjithë” mbështetur nga Bashkimi European dhe implementuar nga People In Need Kosova, The Ideas Partnership dhe Autizmi Flet.





VAKSINOHU!

✦ #Bashkëiadalim



LIPJAN



KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM



BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET